

**PROCES VERBAL - Tipi i kontratës – PUNË
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky proces verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROKURIMIT: NDERTIMI UJESJELLESIT TE FSHATIT GUSMAR, BASHKIA
TEPELENE**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- (CPV): 45000000-7 – Punë ndërtimi per ujesjelles

VLERA E FONDIT LIMIT: 70,193,224.2 lekë pa tvsh (Shtatëdhjetë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e dyqind e njëzet e katër lekë e njëzet qindarka).

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj; 8 (tete) muaj

Afat prej **8 (tetë) muajsh** është përcaktuar në përputhje me volumin, kompleksitetin dhe rendin teknologjik të punimeve, të cilat përfshijnë rikonstruksimin e kaptazhit, ndërtimin e linjës së dërgimit, depos 100 m³, rrjetit të shpërndarjes, lidhjeve të konsumatorëve dhe montimin e pajisjeve teknologjike. Ky afat mundëson zhvillimin paralel të disa fronteve të punës, respektimin e kohëve teknologjike, kryerjen e provave dhe vënien në funksion të sistemit, duke garantuar realizimin e plotë dhe cilësor të kontratës.

Në bazë të Nenit 21 pika 2 të Ligjit Nr.162 / 2020 “Për Prokurimin publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr. 16 datë 08.02.2024 Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78,pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit publik”, të ndryshuar, njësia e prokurimit pranë Autoritetit Kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjiellës – Kanalizimeve, Gjirrokaster Sh.a, ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto ¹ X

Sipas rëndësisë:

Çmimi ☐	pikët 50
Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit ☐	pikët 20
Stafi / Organizimi i Kompanise ☐	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social ☐	pikët 10
Periudha e garancisë së objektit ☐	pikët 5

Kjo kërkesë është bërë në zbatim të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, neni 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” ku përcaktohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose koston, duke përdorur metodën e efektivitetit të koston, siç janë koston gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshijnë: a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit. Elementi i koston, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve, ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

5. Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit. Njësia e Prokurimit shpalli kërkesën për Grafikun e punimeve dhe kohën e mobilizimit dhe ka kërkuar për këtë kriter 20 pikë,

duke vlerësuar rëndësinë që ka ky element në përfundimin e plotë dhe realizimin me sukses të çdo veprë, pasi duke ndërthurur elementin cilësi, saktësi dhe precizion në kryerjen e punimeve, por edhe angazhimin realisht të të gjithë stafit, inxhinierë, teknikë, specialistë, punëtorë të thjeshtë, ndihmës etj, mund të arrihet që punimet të kryhen edhe më shpejt se koha e planifikuar nga autoriteti kontraktor por dhe njëherësh me cilësinë e duhur, duke i dhënë besimin këtij autoriteti për angazhimin serioz dhe të plotë të operatorit ekonomik pjesëmarrës i cili në përfundim do të sjellë rezultatet e kërkuara dhe të pritura nga ky autoritet. Operatori Ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori Ekonomik ofertues duhet të argumentojë (në mënyrë përshkimore dhe grafike) kohën e propozuar të kryerjes së punimeve.

Po kështu një rëndësi e vecantë nga autoriteti kontraktor i jepet edhe elementit Stafi / Organizimi i Kompanisë, i cili vlerësohet deri në 15 pikë, duke ditur që vetëm një staf i kualifikuar profesional inxhiniero - teknik dhe me përvojën e duhur mund të sjellë rezultatet e dëshiruara dhe të pritura nga autoriteti kontraktor për përfundimin me sukses të objektit të prokurimit. Një operator ekonomik i cili ka një staf të tillë mund të konkurrojë me cilësi pranë autoritetit kontraktor dhe të përmbushë të gjithë detyrat e projekt preventivit të parashikuar nga autoriteti kontraktor. Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se do të angazhojë në kontratë një staf me përvojë / eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Disa nga nënkriteret janë formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushën specifike i cili provohet me dokumentacionin përkatës. Gjithashtu operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe skemën e organizimit të stafit të propozuar për realizimin e kontratës, organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjinë e ndërveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor etj.

Në lidhje me Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, autoriteti kontraktor ka kërkuar deri në 10 pikë, duke ditur rëndësinë që ka mjedisi aktualisht dhe fakti që me veprimet apo mosveprimet tona ndikojmë në mjedis dhe në komunitetin tonë të përbashkët pozitivisht / negativisht. Duke patur parasysh se përvec realizimit të veprës duhet që të aplikohet nga operatorët realizues të punimeve edhe parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit. Duke ditur që nga punimet që do të kryhen gjatë ndërtimit të një veprë mund të krijohen mbetje inerte, detyrat kryesore që do të ketë parasysh operatori ekonomik janë ndër të tjera edhe kontrolli i vazhdueshëm i gjendjes së mjedisit në territorin ku do të zhvillohet aktiviteti, mbajtja pastër e gjithë territorit ku kryhet veprimtaria, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në mjedis, florë dhe faunë, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në popullsi, shëndetin human, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në klimë, ajër, ujë, tokë etj.

Në veçanti duhet t'i kushtojë rëndësi edhe faktorëve: Respektimi i procedurave, normave, standarteve dhe planifikimet e paraqitura në projekt gjatë realizimit të tij si dhe të kontrollojnë vazhdimisht ecurinë e treguesve mjedisorë.

Për të gjitha këto elementë operatori ekonomik pjesëmarrës bën një pasqyrë të qartë dhe të detajuar që në momentin kur ai konkuron në procedurën e prokurimit duke dhënë Propozime konkrete se si do të ndikojë në uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, dhe më pas autoriteti kontraktor bën vlerësimin real me pikëzim të çdo operatori ekonomik ofertues. Nënkreret për operatorët

ekonomikë pjesëmarrës në këtë rast dhe që do të vlerësohen në mënyrë të pikëzuar nga Komisioni Vlerësimit të Ofertave i Autoritetit Kontraktor, do të jenë:

1. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efëente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore.

2. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve.

Një rëndësi e vecantë i është dhënë edhe Periudhës së garancisë së objektit e cila tregon jetëgjatësinë e objektit, faktin se sa më maksimale të jetë periudha që përfshin garancinë e veprës, e deklaruar nga operatori ekonomik pjesëmarrës, aq më tepër autoriteti kontraktor bindet për angazhimin, seriozitetin dhe kapacitetin e këtij operatori ekonomik, me qëllimin final realizimin përfundimtar të veprës dhe marrjen në dorëzim të saj.

Një rëndësi të vecantë nga autoriteti kontraktor i jepet dhe punesimin të punekerkuesve ku Operatori Ekonomik fitues garanton se do te punesoje nje numer personash, te cilet klasifikohen si “punekerkues pa pune” duke i kushtuar nje vemendje te vecante punesimit te personave te papune, kryesisht ne zonen ku do te zhvillohet procedura e prokurimit.

Në bazë të Nenit 21 pika 2 të Ligjit Nr.162 / 2020 “Për Prokurimin publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr. 16 datë 08.02.2024 Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78,pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit publik”, të ndryshuar, njësia e prokurimit pranë Autoritetit Kontraktor SHRUKGJ, ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionarit ose ortakut, apo personit me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese, persona të cilët janë ose kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, gjatë kohës që vendimi i përjashtimit është në fuqi;

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet për pagat bazë referuese sipas kategorive të profesioneve për punonjësit e punësuar, kur kjo kërkesë zbatohet.

Dokumentet në gjuhë të huaj paraqiten të shoqëruara me përkthim në gjuhën shqipe sipas kërkesave të dokumenteve standarde të tenderit dhe legjislacionit në fuqi.

Këto kritere përmbushen paraprakisht me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik në ditën e hapjes së ofertave, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Në rast se operatori ekonomik ofertues mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas përcaktimeve në Kriteret e Përgjithshme të Perzgjedhjes / Kualifikimit pika 1 e Shtojcës 7

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në kërkesat e pikes 1, Shtojca 7

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit **2023, 2024, 2025** të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e germës “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit **2023, 2024, 2025** lëshuar nga Administrata Tatimore, ku xhiro mesatare e këtyre tre viteve të jetë me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vertetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2025 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar të vitit 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” te ndryshuar, ku përcaktohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: b) **gjendjen ekonomike dhe financiare; ...3.** Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, **paragrafi 1 dhe 2 germa “b”**, parashikohet: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare¹. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht: Ligjit Nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 i tij i cili përcakton: “Çdo tatimpagues përgatit **deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme** në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, **duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël**, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji; Udhëzimit të

Ministrit të Financave Nr.5 datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Pika 3.12 e tij, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25 date 10.05.2018 "Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 9 ku parashikohet: "Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përjashtimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministri përgjegjës për financat"; Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 "*Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar*" (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 "*Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike*". Ne keto kushte, vleresojme të kërkojme kete dokumentacion pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij si dhe akt ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Njësia e prokurimit kerkoi edhe **pagesat e taksave vendore** bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*"(te ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga çdo njesi e qeverisjes vendore si dhe faktit se në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar dhe për qëllim të rregjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qenë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet qe ushtrojne aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:

Ne rast se punimet jane kryer me ente publike:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme te realizuar me ente publike, duhet te paraqese Kontratën e Sipërmarrjes; formular vleresimi leshuar nga Investitori sipas Shtojces 9;situcion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve;Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore; Aktin e Kolaudimi; dhe Certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përhershëm .

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ne rast se punimet jane kryer me sektorin privat:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet te paraqese vertetime te shoqeruara me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” te ndryshuar).

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet te paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi **të përshtatshëm** cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës. Përvojat e mëparshme janë element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Kriteri i kapacitetit teknik siguron se operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedure kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer punën me cilësi të lartë. Përdorimi i operatorëve me përvojë të mëparshme siguron që puna do të kryhet me sukses dhe pa ndërprerje. Përvoja e mëparshme në projekte të ngjashme siguron që operatorët janë të gatshëm për situata të papritura dhe janë në gjendje të menaxhojnë situatat e mundshme në mënyrën e duhur. Kriteri i kapacitetit teknik ndihmon në sigurimin e një konkurrence të ndershme dhe të përshtatshme në procedure.

Referuar këtij neni, njësia e prokurimit vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentave ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit”(i ndryshuar), si dhe akteve dhe VKM të dala në zbatim të tij, pasi duke qenë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të

përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të paraqesin dhe situacionet përfundimtare si dhe formular vleresimi për punët e kryera me entet publike. Kjo bëhet me qëllim që autoriteti kontraktor të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punimet e mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Meqënëse paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit të përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Gjithashtu është kërkuar në DST:

➤ Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

➤ Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, sipas parashikimeve të nenit 88 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni autoriteti kontraktor ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që Autoriteti Kontraktor të përllogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1.

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

- a) Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë kriter, duhet të paraqesë liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 *“Për Miratimin e Rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve Juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, i ndryshuar.

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë profesionale të shoqërisë, të vlefshme, për kategoritë e mëposhtme:

- | | |
|---|----------------------|
| • Kategoria NP- 1 Punime gërmimi në tokë | Klasifikimi A |
| • Kategoria NP- 4 Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai.... | Klasifikimi A |
| • Kategoria NP- 7 Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje | Klasifikimi B |
| • Kategoria NP-12 Punime te inxhinierise Mjedisore | Klasifikimi A |
| • Kategoria NS-18 Punime topogjeodezike | Klasifikimi A |

Në rastet e mbështetjes në kapacitete të subjekteve të tjera / Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t’i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin / njehsimin e liçencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s’kualifikues.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 *“Për Prokurimin Publik”* në të cilët përcaktohet: *“Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”*.

Në nenin 39 *“Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”* pika 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”* përcaktohet *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) **licenca profesionale** të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”*

VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 të ndryshuar “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4). Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (të ndryshuar), si dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në liçensën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlojit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës. Llojet e licencave dhe niveli i klasifikimit të tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt. Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategoritë respektive është kërkuar bazuar në zërat e punimeve që parashikohen të kryhen dhe që përfshihen në kategorinë përkatëse brenda vlerave të kufijve të parashikuara në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar.

Sipas VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 të ndryshuar, përcaktohet:

Kategoria N.P - 1 “Punime gërmimi në tokë” Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore. Kjo kategori është kërkuar duke patur parasysh punimet për këtë kategori si: gërmime dheu me mjetet eskavator me goma, me zinxhir etj, që do të kryhen me qëllim ndërtimin e linjave të transmetimit të ujësjellësit duke arritur në përfundim realizimin e sukseshëm të objektit dhe veprës.

Kategoria N.P – 4 “Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tranvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvaji, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndërtuar paqëndrueshmërinë mbi "goma", "hekur", "zona", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore

Kategoria N.P-7 “Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje” Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet

mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pishëm, ujësjellsat, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura. Kjo kategori licence i referohet **objektit të kontratës dhe punimeve kryesore** që parashikohen në preventiv për realizimin e veprës konkretisht ndërtimin e linjës së transmetimit, ndërtimin e depove grumbulluese të ujit, me zërat kryesorë furnizim vendosje tuba dhe rakorderi, furnizim vendosje matësa dhe stacion pompimi.

Kategoria N.P-12 “Punime të inxhinierisë së mjedisit” kërkohet pasi punimet objekt kontrate nuk kufizohen vetëm në vendosjen e tubacioneve, por përfshijnë edhe ndërhyrje që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në terren, në mjedisin natyror dhe në ruajtjen e funksionimit normal të zonës ku ndërtohet ujësjellësi. Në këtë kuptim, operatori ekonomik duhet të ketë kapacitetin profesional për të realizuar punime që lidhen me sistemimin, rehabilitimin dhe mbrojtjen e mjedisit ku kryhet ndërhyrja.

Kërkesa për këtë kategori licence synon të garantojë që operatori ekonomik ka aftësinë ligjore dhe profesionale për të zbatuar punime që kërkojnë kujdes të veçantë në lidhje me mjedisin, burimet ujore, terrenin, shmangien e dëmtimeve gjatë gërmimeve dhe rikthimin e zonave të ndërhyrjes në kushte të përshtatshme pas përfundimit të punimeve.

Objekti i kontratës lidhet me ndërtimin e një sistemi ujësjellësi, ku krahas punimeve të rrjetit hidrik, parashikohen edhe ndërhyrje në terren, hapje traseje, gërmime, sistemime, mbushje, rikthim i sipërfaqeve në gjendjen e mëparshme, mbrojtje e burimit/kaptazhit, si dhe masa për shmangien e ndikimeve negative në mjedis gjatë dhe pas zbatimit të punimeve.

Kategoria NS-18 “Punime topogjeodezike” Kjo kategori licence përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike etj.

Eshtë kërkuar kjo kategori license në përputhje me punimet që do të realizohen gjatë fazës së zbatimit duke u orientuar me kuotat, saktësinë e gjurmës së linjave, volumin e gërmimeve etj, bazuar në projekt preventivin e punimeve. Gjithashtu, sipas parashikimeve në specifikimet teknike dhe raportin topografik të publikuar, del e domosdoshme për piketimet e kanaleve që do të gërmohen, ndërtimin e depove, sistemimet e volumeve të dherave dhe azhurnimet topografike të cilat shtrihen në të gjithë nënobjektet e preventivit.

b) Certifikatat që duhet të paraqesin Operatorët Ekonomikë:

- Certifikatë ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, objekti i se cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikatë ISO 14001-2015 “Për Sistemin e menaxhimit të mjedisit”, objekti i se cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikatë ISO 45001-2018 “Për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, ose certifikatë me standartin e përditësuar Certifikatë ISO 45001-2023, objekti i se cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

Shënim: Për certifikatat e mësipërme Operatorët Ekonomikë ofertues mund të paraqesin dokument ekuivalent që standartizon këto certifikata sipas standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto certifikata janë unifikuar nga kjo Drejtori.

Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontrates së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **certifikata** të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit. Në bazë të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje

me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme. Referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për të vërtetuar se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime. Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret si më lart duke qenë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës, por edhe sepse ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin e besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Çertifikatë ISO 9001 - 2015 “Per Sistemin e menaxhimit te cilesise”, mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi si dhe mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësive, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj. Kjo kërkesë shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që operatori ekonomik ofertues është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë.

Çertifikatë ISO 14001-2015 “Per sistemin e menaxhimit te mjedisit” kerkohet pasi angazhimi per mbrojtjen e mjedisit eshte nje kriter madhor ne zgjedhjen e nje prodhuesi, kurse metoda me efikase per te shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin eshte zbatimi i nje sistem menaxhimi per mjedisin konform me parashikimet e standartit nderkombetar ISO 14001. Kërkesa lidhur me çertifikimin ISO 14001:2015 bëhet pasi zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kontrates. Të gjitha punimet e parashikuara në vepër duhen kryer në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të përgatitur nga projektuesi, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu kjo çertifikatë është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik *për marrjen e masave të nevojshme mjedisore ndaj dëmtimit të mjedisit kontrolluar duke minimizuar aq sa lejon sistemi*, ku gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis, si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra, ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

Certifikatë ISO 45001-2018 “Për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në pune”, ose certifikatë me standartin e përditësuar **Cerifikatë ISO 45001-2023** mundëson që çdo shoqëri të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, dhe përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve, hetimin e incidenteve etj.

Kjo kërkesë është vendosur duke iu referuar natyrës dhe specifikës që mbart objekti i prokurimit që lidhet me procese pune ndërtimi. Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta e për këtë arsye, Autoriteti kontraktor duhet të sigurohet se Operatorët ofertues zotërojnë kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin e risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës. Pajisja me këtë lloj certifikate dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky

standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës. Çertifikatë ISO 45001, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik *në lidhje me vlerësimin e rrezikut dhe përgatitjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/ eliminuar rreziqet të cilat u ekspozohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor*, ku veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci shtesë që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

- **Shënim:** Për certifikatat e mësipërme Operatorët Ekonomikë ofertues mund të paraqesin dokument ekuivalent që standartizon këto certifikata sipas standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto certifikata janë unifikuar nga kjo Drejtoria.
- Tuba ujësjellësi HDPE
- Tuba dhe rakorderi, celiku

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Autorizim të Prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.
- Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.
- Operatori Ekonomik për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqesë certifikatë/vetëdeklarim nga Prodhuesi që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015 ose ekuivalent. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.
- Të gjitha materialet e mësipërme duhet të jenë sipas Standarteve Europiane të pajisura me certifikatë Konformiteti ose deklarata konformiteti CE.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Shënim: Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtoria.

Tuba HDPE

- Operatori Ekonomik të paraqesë certifikatë ose deklaratë nga prodhuesi / distributori i autorizuar që vërteton se tubat HDPE janë të certifikuara “Per sisteme të furnizimit me ujë të pijshëm nën presion”/ dokument ekuivalent që vërteton përputhshmërinë e tubave me standartet e zbatueshme.

Shënim: Dokumentacioni i paraqitur duhet të vërtetojë se tubat HDPE janë prodhuar sipas standardit **SSH EN 12201-2:2024 / EN 12201-2 / ISO 4427 ose ekuivalent**, për sisteme tubacionesh plastike prej polietileni për furnizim me ujë dhe/ose sisteme nën presion.

Tubat duhet të jenë të përshtatshëm për përdorim në rrjete ujësjellësi, për transport të ujit të pijshëm, me klasë presioni, diametër, SDR dhe karakteristika teknike sipas specifikimeve të projektit dhe preventivit.

Në tub duhet të jenë të shënuara në mënyrë të dukshme dhe të lexueshme të dhënat kryesore teknike, si: emri/marka e prodhuesit, materiali PE/HDPE, diametri nominal, klasa e presionit PN, SDR, standardi i prodhimit, data/lot-i i prodhimit dhe çdo element tjetër identifikues teknik i produktit.

Argumentimi: Paraqitja e ketyre dokumenteve është vlerësuar pasi në objekt kemi të bëjmë me materiale (artikuj) që do të vendosen në vepër, bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, duhet që këto artikuj të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: **Autorizim prodhuesi ose distributori, katalogët ose pjesë të tyre**, me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Ky objekt, një ndër elementet më të rëndësishëm të tij ka cilësinë e materialeve tubacione të ujësjellësit, matësa etj, që do të vendosen në objekt, cilësinë e zbatimit të punimeve dhe atë të artikujve, në mënyrë që të arrijë qëllimet e tij afatgjata.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e blerjes së artikujve të sipërcituar. Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën e caktuar. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në treg. Përmes këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte. Gjithashtu kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plotë të Prodhuesit, Autoriteti ka mundësi të kontaktoje me Prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë. Kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose

distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

Vendosja e kriterit për **paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit** është i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara. Paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të mallrave. Kjo siguron që Autoriteti të ketë një pamje të qartë për cilësinë dhe aftësitë e mallrave që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave. Kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mallrat e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike. Gjithashtu, bazuar në preventivin e punimeve, ku përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ato duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t'i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/ materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, **me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga Autoriteti nëse këto materiale/ pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit**, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të çertifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standarteve të miratuara.

Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet se, citojmë: **“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.**

Argumentim teknik i kriterit për tuba HDPE

Kërkesa për paraqitjen e certifikatës, deklaratës së prodhuesit ose dokumentit ekuivalent për tubat HDPE vendoset për të garantuar që materiali që do të furnizohet dhe vendoset në vepër është i përshtatshëm për ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit.

Duke qenë se objekti i kontratës lidhet me ndërtimin e një sistemi të furnizimit me ujë, tubat përbëjnë elementin kryesor funksional të veprës. Cilësia e tyre ndikon drejtpërdrejt në sigurinë e furnizimit me ujë, qëndrueshmërinë e rrjetit, rezistencën ndaj presionit, jetëgjatësinë e investimit dhe shmangien e defekteve gjatë periudhës së shfrytëzimit.

Për këtë arsye, kërkohet që tubat HDPE të jenë të certifikuar ose të shoqëruar me dokumentacion teknik që vërteton përputhshmërinë me standardet përkatëse për sisteme të furnizimit me ujë nën presion, si SSH EN 12201-2:2024 / EN 12201-2 / ISO 4427 ose ekuivalent. Ky standard lidhet me tubat prej polietileni për sisteme të furnizimit me ujë dhe sisteme nën presion.

Kjo kërkesë nuk ka qëllim kufizimin e konkurrencës, pasi pranohen edhe dokumente ekuivalente, standarde ekuivalente dhe dokumentacion i lëshuar nga prodhuesi, distributori i autorizuar ose trupa certifikimi të akredituara. Qëllimi i saj është të sigurojë që produkti i ofruar përputhet me kërkesat teknike të projektit, është i përshtatshëm për përdorim në rrjete ujësjellësi dhe garanton funksionimin normal të veprës pas përfundimit të punimeve.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik
- 1 (nje) Inxhinjer Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinjer Mjedisi
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet/ Topograf

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8. Formulari i vetëdeklarimit duhet

të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Operatori ekonomik pjesëmarrës, në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, duhet të përcaktojë me anë të një **deklarate** (nënshkruar nga Administratori i Shoqërisë), **Drejtnesin Teknik të punimeve** (inxhinier me eksperiencë) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërise dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të vepohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

❖ *Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetedeklarimin sipas Formularit të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës Nr.8 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV.*

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të certifikuar me dëshmi trajnimit si “Person i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë” të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kërkesë kjo në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.10237 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

Në rastin e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, sipas nenit 88 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, secili prej operatorëve ekonomike duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1(një) “Person të ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit.

- 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, të pajisur me certifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH.

Shenim: Për specialistin “Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, Operatori Ekonomik mund ta disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune/shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë Diplomë/Certifikatat e cituara më sipër.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërise ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qëllim. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr.742 datë 06.11.2003, duhet të plotësojë këtë kërkesë, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese". Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punetore prej minimalisht **50 (pesëdhjetë)** për periudhën, 3 muajë nga momenti i hapjes së ofertave e vertetuar kjo me:

- Vertetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën 3 muajë nga momenti i hapjes së ofertave.

** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.*

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mesipërme.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesipërme.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë të punësuar stafin teknik të përbërë nga të paktën **22 (njetëzet e dy)** punonjës të specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit që kryejnë dhe të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit, duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit, me profesione si më poshtë:

- 2 (dy) teknike ndertimi
- 1 (një) teknik mekanik
- 2 (dy) karpentier
- 2 (dy) hidroizolues
- 1 (një) betonues
- 3 (tre) hidraulike
- 1 (një) montator për konstruksione metalike
- 2 (dy) hekurkthyes
- 2 (dy) elektricist
- 2 (dy) shofere për drejtimit mjeteve të pajisur me leje drejtimi me kategorinë "C" dhe/ose "CE" dhe/ose "D" dhe/ose "DE" lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, diplomë profesionale/dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për specialistët e mësipërm të paraqiten kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme, të lëshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve.

Shënim: Për shoferët, Operatori Ekonomik pjesëmarrës mund t'i disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune / shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

-Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të paktën:4 (kater) Manovratorë:

- 2(dy) Eskavatoristë
- 1(një)Automakinist
- 1(një) Buldozierist,

të cilët mund të jenë pjesë e stafit ose të kontraktuar me kontratë pune/shërbimi, për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune / shërbimi të vlefshme; Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor; Kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme të lëshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve.

(Në rastin kur punonjesit manovrator, eskavatorist, automakinist, Buldozierist dhe shofer jane të kontraktuar me kontrate pune (respektivisht per mjetet e marra me qera), nuk kerkohet te figurojnë në listpagesat e shoqërise).

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë **burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, **si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.**” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe /ose c) **fuqinë punëtore të operatorit ekonomik** të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Për fuqinë minimale punëtore prej 50 (pesëdhjetë) personash

Në mbështetje të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 39, pikat 4 dhe 6, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë fuqinë minimale punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Kjo kërkesë duhet të jetë në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me natyrën, volumin, vlerën dhe afatin e kontratës.

Numri minimal prej **50 (pesëdhjetë) punonjësish** është përcaktuar pas analizimit të projektpreventivit, grafikut të punimeve, volumeve të punës, numrit të fronteve që do të zhvillohen paralelisht dhe nevojës për realizimin e kontratës brenda afatit të parashikuar prej **8 muajsh**.

Objekti përfshin disa kategori punimesh të ndryshme dhe të ndërlidhura, konkretisht:

- rikonstruksionin e kaptazhit;
- ndërtimin e linjës së dërgimit me gjatësi rreth 335 ml;
- ndërtimin e linjave të shpërndarjes me gjatësi totale rreth 6,293 ml;
- ndërtimin e linjave dhe kasetave individuale për 98 lidhje konsumatore, me rreth 980 ml tubacion;
- ndërtimin e një depoje të re me kapacitet 100 m³;

- ndërtimin e pusetave të ajrimit dhe të manovrimit;
- punime gërmimi, transporti, mbushjeje, ngjeshjeje, shtresash rrugore dhe rikthimi të sipërfaqeve;
- punime betonarmeje, ku për depon parashikohen rreth 140 m³ beton strukturor, rreth 10 ton hekur beton, punime kallëpesh, hidroizolimi dhe shtresa mbrojtëse;
- punime hidraulike, mekanike, teknologjike dhe elektrike për pajisjen dhe funksionimin e depos dhe të rrjetit.

Vetëm për linjat e shpërndarjes preventivi përmban volume të konsiderueshme, ndër të tjera, mbi 4,150 m³ gërmime, rreth 3,946 m³ transport materialesh, rreth 2,569 m³ mbushje me gur kave, si dhe mbi 3,000 m² shtresa stabilizanti dhe çakëlli. Këto punime kërkojnë angazhimin e njëkohshëm të makinerive, manovratorëve, drejtuesve të mjeteve, hidraulikëve dhe punëtorëve ndihmës për hapjen e kanaleve, shtrimin dhe montimin e tubacioneve, mbushjen, ngjeshjen dhe rikthimin e sipërfaqeve.

Sipas grafikut të punimeve, gjatë zbatimit do të ketë disa fronte pune që zhvillohen në të njëjtën kohë. Në muajt 6-8 parashikohet zhvillimi paralel i deri në **katër fronteve kryesore**, përkatësisht:

1. ndërtimi i linjave të shpërndarjes;
2. ndërtimi i lidhjeve të konsumatorëve;
3. ndërtimi i depos së re 100 m³;
4. ndërtimi i linjës së dërgimit ose realizimi i pjesës teknologjike të depos.

Gjithashtu, në muajt e parë zhvillohen paralelisht punimet në rrugën e shërbimit, rikonstruksioni i kaptazhit dhe punimet në linjat e shpërndarjes.

Për realizimin normal të këtyre fronteve është bërë kjo përlllogaritje e fuqisë punëtore:

Kategoria e personelit	Numri minimal
Personeli kryesor drejtues: inxhinier ndërtimi, elektrik, hidroteknik, mekanik, mjedisi, gjeolog dhe gjeodet/topograf	7
Person përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë	1
Punonjës të specializuar sipas profesioneve të kërkuara	18
Manovratorë të makinerive të rënda	4
Punëtorë të përgjithshëm dhe punonjës mbështetës	20
Gjithsej	50

Në grupin prej **18 punonjësish të specializuar** përfshihen teknikët e ndërtimit dhe mekanikë, karpentierët, hekurkthyesit, betonuesi, hidroizoluesit, hidraulikët, montatori i konstruksioneve metalike, elektrikistët dhe drejtuesit e mjeteve. Së bashku me **4 manovratorët**, numri i personelit teknik dhe të specializuar arrin në **22 punonjës**.

Punëtorët e përgjithshëm dhe mbështetës janë të nevojshëm për:

- gjurmimet dhe sistemet manuale në zonat ku nuk mund të ndërhyhet me makineri;
- përgatitjen e shtratit të tubacioneve;
- uljen, pozicionimin dhe mbajtjen e tubave gjatë montimit;
- mbushjen, përhapjen dhe ngjeshjen e materialeve;
- transportin dhe lëvizjen e materialeve brenda kantierit;
- punimet ndihmëse të betonimit, kallëpeve dhe hekurit;
- realizimin e 98 lidhjeve individuale dhe vendosjen e kasetave të matësve;
- rikthimin e rrugëve, trotuareve, mureve dhe sipërfaqeve të dëmtuara;
- vendosjen e sinjalistikës, rrethimin dhe mirëmbajtjen e sigurisë së fronteve të punës.

Kërkesa për të disponuar jo më pak se **50 punonjës për secilin nga tre muajt e fundit përpara datës së hapjes së ofertave** synon të vërtetojë se operatori ekonomik ka një strukturë të qëndrueshme organizative dhe fuqi punëtore reale, të deklaruar dhe të siguruar, e cila mund të mobilizohet menjëherë për realizimin e punimeve. Kjo kërkesë shmang mbështetjen vetëm në punësime të përkohshme dhe garanton vazhdimësinë e punimeve në disa fronte, pa cenuar afatin, cilësinë dhe sigurinë në kantier.

Për rrjedhojë, numri minimal prej **50 punonjësish** vlerësohet i domosdoshëm, i arsyeshëm dhe proporcional me volumin e punimeve, kompleksitetin teknik, numrin e fronteve paralele dhe afatin 8-mujor të realizimit të kontratës.

Ndërkohë, me qëllim ndërtimin e objektit të veprës sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë, duke qenë se vlera e preventivuar për punimet që do të kryhen është mbi 30,000,000 milion në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, njësia e prokurimit vlerëson që operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate **Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt, të përfshirë në liçensimin e shoqërisë, si dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Drejtuesi teknik duhet të disponojë kualifikimet e kërkuara, ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*.

Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej 50 punonjës, për të paktën 3 muajt e fundit, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në këtë përlllogaritje njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentat e tenderit, periudhën **8 muaj**, dhe në përfundim në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentat konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përmbushjen e këtyre kushteve.

Në staf përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë, punonjës të kualifikuar, drejtues të mjeteve të thjeshta apo të rënda etj, duke patur parasysh njëkohësisht volumin e punimeve, grafikun, llojin dhe natyrën e punimeve që do të kryhen si: gjurmime, ngjeshje, sisteme, shtrim tubacione,

punimet për rrjetin, pusetat, depot, pusin, shpime me sonde, stacion pompimi, rehabilitim i segmenteve rrugore etj, të cilat duhet të realizohen brenda afatit të parashikuar të objektit, 18 muaj. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. **Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve.** Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllim për të patur rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin rigoroz të punimeve. Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës, me qëllim ndërtimin e investimit sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, referuar zërave (natyrës) të punimeve që do të kryhen objekt kontrate, vlerësojmë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e drejtuesve teknik (*inxhinierët*) me kualifikimet e kërkuara. Kërkesa specifike për inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë preventivit të punimeve (*nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik*), ku citojmë: **Drejtuesi teknik është përgjegjës** për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës objekt prokurimi, me qëllim ndërtimin e investimit sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e drejtuesve teknik (*inxhinierët*) me kualifikimet e kërkuara.

Është kërkuar të ketë në staf **Inxhinier Ndërtimi** i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e preventivit për anën ndërtimore, kryesisht në ndërtimin e depove grumbulluese, punimet murature, dhomes se klorinimit, godinave së stacioneve të pompimit etj. Gjithashtu inxhinieri i ndërtimit bën kontrollin e punimeve të betonit në pusetat, muret dhe kolonat b/a, soletat si dhe në punime të parashikuara për depo, armime, etj. Ky inxhinier do të jetë përgjegjës për menaxhimin e zbatimit të punimeve ndërtimore, analizimin e projektit pasi kemi të bëjmë me punime ndërtimi ku është e nevojshme suporti teknik i tij si dhe ndjekja e ecurisë së punimeve në kantonier.

Është kërkuar të ketë në staf **Inxhinier Elektrik**, pasi objekti i kontratës përfshin punime elektrike që lidhen me funksionimin e sistemit të ujësjellësit, kryesisht në dhomat teknike, panelet elektrike, furnizimin me energji, komandimin, sistemet e mbrojtjes elektrike, tokëzimin, automatizimin, ndriçimin teknik dhe pajisje të tjera elektrike të parashikuara në projekt.

Inxhinieri elektrik do të jetë përgjegjës për kontrollin e zbatimit të punimeve elektrike, montimin dhe verifikimin e pajisjeve elektrike, lidhjen e paneleve, mbrojtjen nga mbingarkesat, kontrollin e sistemit të komandimit dhe sigurimin që instalimet të realizohen në përputhje me projektin elektrik, standardet teknike dhe kushtet e sigurisë. Duke qenë se funksionimi i pajisjeve

elektromekanike varet nga siguria dhe cilësia e instalimeve elektrike, kërkesa për këtë specialist është e nevojshme dhe e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës.

Konkretisht, është kërkuar të ketë në staf **Inxhinier Hidroteknik** i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidraulike që do të bëhen për objektin e veprës, ndertimin e rrjetit të transmetimit të ujesjellesit, punime hidraulike për depot grumbulluese, ndertimin e stacioneve të pompimit, furnizim vendosje e tubave dhe rakorderive përgjate rrjetit, shtrimit të linjave të dërgimit, vendosje matesa etj. Ky inxhinier është përgjegjës për zbatimin e saktë të këtyre punimeve lidhur me zërat e preventivit dhe kontrollin e tyre duke ruajtur vijën pjezometrike të tubacionit. Është e nevojshme që punimet të zbatohen dhe kontrollohen në mënyrë konkrete nga ana e inxhinierit me profilin e duhur.

Është kërkuar të ketë në staf **Inxhinier Mekanik**, pasi sistemi i ujësjiellësit përfshin elementë dhe pajisje mekanike/hidromekanike të domosdoshme për funksionimin e tij. Këto përfshijnë, valvola, saracineska, rakorderi, flanaxha, bashkues, reduktorë presioni, ajruer, shkarkues, matës, pajisje klorinimi dhe elementë të tjerë mekanikë që janë pjesë e projektit dhe preventivit.

Inxhinieri mekanik do të jetë përgjegjës për ndjekjen e montimit të pajisjeve mekanike, kontrollin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike, verifikimin e lidhjeve me tubacionet, kontrollin e funksionimit të pajisjeve hidromekanike, si dhe pjesëmarrjen në kolaudimin dhe vënien në punë të sistemit. Prania e këtij specialisti është e nevojshme për të garantuar që pajisjet mekanike të instalohen saktë, të funksionojnë në mënyrë të sigurt dhe të sigurojnë vazhdimësinë e furnizimit me ujë.

Është kërkuar të ketë në staf **Inxhinier Mjedisit**, pasi realizimi i punimeve për ndërtimin e ujësjiellësit shoqërohet me ndërhyrje në terren, hapje traseje, gërmime, transport dhe depozitim materialesh, administrim të dherave të dala nga gërmimi, rikthim të sipërfaqeve në gjendjen e mëparshme dhe masa për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit të punimeve.

Inxhinieri i mjedisit do të jetë përgjegjës për ndjekjen e masave mjedisore në kantier, kontrollin e ndikimeve në tokë, ujë, vegjetacion dhe zonat përreth, si dhe për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë punimeve. Ky specialist është i nevojshëm për të garantuar që punimet të kryhen duke respektuar kërkesat mjedisore, duke shmangur dëmtimet e panevojshme dhe duke siguruar rehabilitimin e zonave të prekura nga punimet. Duke qenë se ujësjiellësi është vepër lineare dhe prek sipërfaqe të ndryshme përgjatë trasesë, prania e këtij specialisti është e justifikuar.

Është kërkuar të ketë në staf **Inxhinier Gjeolog**, pasi objekti përfshin punime gërmimi, hapje traseje për vendosjen e tubacioneve, ndërtim pusetash, depozitash, dhomash teknike, bazamentesh dhe elementësh të tjerë që lidhen drejtpërdrejt me kushtet gjeologjike dhe gjeoteknike të terrenit.

Inxhinieri gjeolog do të jetë përgjegjës për vlerësimin e kushteve të terrenit gjatë zbatimit të punimeve, evidentimin e formacioneve tokësore ose shkëmbore, praninë e ujërave nëntokësore, qëndrueshmërinë e skarpave dhe gërmimeve, si dhe për dhënien e rekomandimeve teknike në rast të hasjes së problematikave gjatë hapjes së trasesë. Ky specialist është i nevojshëm sidomos në segmente ku terreni është i pjerrët, i paqëndrueshëm, shkëmbor ose ku ekziston rrezik për

shembje apo rrëshqitje. Prania e tij garanton sigurinë e punimeve dhe mbrojtjen e tubacionit gjatë dhe pas vendosjes në vepër.

Për kryerjen e punimeve gjeodezike për zbatimin e objektit dhe të gjithë vëllimeve përbërës të tij, nevojitet të angazhohet minimalisht një inxhinier gjeodet / topograf. Është kërkuar të ketë në staf **Inxhinier Gjeodet / Topograf**, i cili është përgjegjës për kontrollin e piketimeve të gërmimeve për realizimin e hapjes së kanalit, hapjes së themeleve dhe sistemet topografike nga fillimi i punimeve deri në përfundimin e tyre. Ky inxhinier është kërkuar në përputhje me punimet që do të realizohen gjatë fazës së zbatimit duke u orientuar me kuotat e objekteve civile, saktësinë e gjurmës së linjave, volumin e gërmimeve etj, bazuar në projekt preventivin e punimeve. Gjithashtu, është i domosdoshëm për piketimet e kanaleve që do gërmohen dhe sistemet topografike të cilat shtrihen në të gjithë nënobjektet e preventivit. Për kryerjen e punimeve gjeodezike për zbatimin e objektit dhe të gjithë vëllimeve përbërës të tij, nevojitet të angazhohet minimalisht një inxhinier gjeodet / topograf. Sikurse specifikohet në Udhëzimin Nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, Dokumentacioni teknik i punimeve të ndërtimit, pika 1, *gjatë zbatimit të punimeve të ndërtimit, në kantier hartohet e grumbullohet dokumentacioni teknik, që vërteton kontrollin e vazhduar, saktësinë dhe cilësinë e punimeve, i cili përmban: a) Dokumentacionin topografik të faktit për vendosjen e objektit e të rrjeteve të infrastrukturës, për lidhjen e themeleve e të bazamenteve me tabanin, për kontrollin në plan e lartësi të objektit, të strukturave mbajtëse etj.*

Janë kërkuar: Punonjës të specializuar/të kualifikuar në pikën 2.3.4

Është kërkuar që operatori ekonomik të disponojë **1 (një) punonjës të certifikuar si “Person i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë”**, pasi objekti i kontratës përfshin punime ndërtimi në kantier, gërmime, hapje traseje, vendosje tubacionesh, punime betoni, ndërtim pusetash, depo, dhoma teknike, përdorim makinerish dhe lëvizje materiale.

Ky punonjës është i nevojshëm për evidentimin dhe parandalimin e rreziqeve gjatë zbatimit të punimeve, kontrollin e përdorimit të mjeteve mbrojtëse, orientimin e punonjësve, si dhe ndjekjen e masave të sigurisë në kantier, me qëllim shmangien e aksidenteve në punë.

Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e punimeve objekt kontrate dhe vendoset në përputhje me Ligjin nr. 10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

Është kërkuar që operatori ekonomik të disponojë **1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin**, pasi gjatë realizimit të objektit do të kryhen punime që lidhen me, dhoma teknike, panele elektrike, instalime elektrike, pajisje elektromekanike, dhomë klorinimi, magazinim të përkohshëm materiale dhe përdorim makinerish në kantier.

Ky specialist është i nevojshëm për ndjekjen e masave parandaluese ndaj zjarrit, kontrollin e kushteve të sigurisë në kantier dhe në ambientet teknike, këshillimin për vendosjen dhe përdorimin e mjeteve fikëse, si dhe orientimin për veprimet që duhet të ndërmerren në rast emergjence.

Kërkesa mbështetet në Ligjin nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin” dhe lidhet me nevojën për garantimin e sigurisë së punonjësve, pajisjeve, objektit dhe infrastrukturës gjatë zbatimit të kontratës.

Lejimi që ky specialist të disponohet edhe me kontratë pune/shërbimi deri në përfundimin e kontratës e bën kriterin proporcional dhe jo kufizues për operatorët ekonomikë.

Kërkesa për këta dy punonjës të specializuar është e lidhur me natyrën e punimeve objekt kontrate dhe synon garantimin e sigurisë në kantier, mbrojtjen e shëndetit të punonjësve, parandalimin e aksidenteve dhe marrjen e masave kundër zjarrit gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Argumentim për pikën 2.3.5 Mjeku i shoqërisë / mjek i kontraktuar

Është kërkuar që operatori ekonomik të disponojë mjek të shoqërisë ose mjek të kontraktuar me kontratë shërbimi, pasi objekti i kontratës përfshin punime ndërtimi në kantier, gjurmime, hapje traseje, vendosje tubacionesh, punime betoni, përdorim makinerish, ngarkim-shkarkim materiale, si dhe punime në depo, puseta, dhoma teknike.

Këto punime paraqesin rrezik për shëndetin dhe sigurinë e punonjësve, ndaj është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë të siguar shërbimin mjekësor për ndjekjen e gjendjes shëndetësore të punonjësve, kontrollin e aftësisë së tyre për punë, këshillimin për parandalimin e dëmtimeve në punë dhe dhënien e ndihmës së nevojshme në rast aksidenti ose emergjence gjatë zbatimit të kontratës.

Kërkesa është në përputhje me Ligjin nr. 10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i cili parashikon detyrimin e punëdhënësit për të garantuar mbrojtjen e punëmarrësve në të gjitha aspektet që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë, si dhe me VKM nr. 692, datë 13.12.2001, të ndryshuar me VKM nr. 742, datë 06.11.2003, që parashikon sigurimin e shërbimit mjekësor nëpërmjet mjekut të ndërmarrjes.

Kërkesa është proporcionale dhe jo kufizuese, pasi operatori ekonomik nuk detyrohet ta ketë mjekun në listëpagesë të përhershme, por mund ta disponojë edhe të kontraktuar nga jashtë, me kontratë shërbimi ose nëpërmjet subjekteve të specializuara për këtë qëllim. Mjeku duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale përkatëse, për të garantuar ushtrimin e ligjshëm dhe profesional të këtij shërbimi.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kjo kërkesë duhet të plotësohet nga secili anëtar i bashkimit që, sipas ndarjes së punimeve në akt-marrëveshjen e bashkëpunimit, merr përsipër zëra punimesh në kantier dhe përmbush kushtet e parashikuara nga aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse.

Kërkesa vendoset për të garantuar mbrojtjen e shëndetit të punonjësve, parandalimin e aksidenteve dhe menaxhimin e rasteve shëndetësore që mund të shfaqen gjatë realizimit të punimeve objekt kontrate.

Argumentimi për pikën 2.3.7

Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë të paktën 22 (njëzet e dy) punonjës/personel teknik për realizimin e punimeve objekt kontrate, nga të cilët:

a) **18 (tetëmbëdhjetë) punonjës të specializuar**, të punësuar dhe të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit, duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit, sipas profesioneve të mëposhtme:

- 2 (dy) teknikë ndërtimi;
- 1 (një) teknik mekanik;
- 2 (dy) karpentierë;
- 2 (dy) hidroizolues;
- 1 (një) betonues;
- 3 (tre) hidraulikë;
- 1 (një) montator për konstruksione metalike;
- 2 (dy) hekurkthyes;
- 2 (dy) elektrikistë;
- 2 (dy) shoferë për drejtim mjetesh, të pajisur me leje drejtimi të kategorisë C dhe/ose CE, dhe/ose kategori të tjera të përshtatshme sipas mjeteve që do të përdoren për realizimin e kontratës.

b) **4 (katër) manovratorë**, të cilët mund të jenë pjesë e stafit ose të kontraktuar me kontratë pune/shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës, si më poshtë:

- 2 (dy) eskavatoristë;
- 1 (një) automakinist;
- 1 (një) buldozierist.

Kërkesat për staf teknik dhe kualifikime duhet të lidhen me objektin, volumnin dhe zërat e preventivit, sipas rregullave të prokurimit publik; ndërsa dëshmitë profesionale mbështeten te Ligji nr. 15/2017 për arsimin/formimin profesional dhe, për manovratorët, te rregullat për dëshminë e aftësisë profesionale për makineritë e rënda.

Nr.	Stafi / profesioni i kërkuar	Sasia	Argumentimi i kriterit
1	Teknik ndërtimi	2	Janë kërkuar teknikë ndërtimi pasi objekti përfshin punime ndërtimore në kantier, si hapje traseje, ndërtim pushtash, depo grumbulluese, dhoma teknike, dhomë klorinimi, bazamente, mure, soleta dhe elementë të tjerë ndërtimorë. Këta teknikë janë të nevojshëm për ndjekjen e përditshme të punimeve, kontrollin e zbatimit sipas projektit dhe rakordimin e punimeve me zërat e preventivit.
2	Teknik mekanik	1	Është kërkuar teknik mekanik pasi sistemi i ujës-jellës përfshin pajisje dhe elementë mekanikë/hidromekanikë, si, valvola, saracineska, flanaxha, rakorderi, ajrues, shkarkues dhe pajisje të tjera teknike. Ky specialist është i nevojshëm për

Nr.	Stafi / profesioni i kërkuar	Sasia	Argumentimi i kriterit
			montimin, kontrollin dhe funksionimin korrekt të këtyre pajisjeve gjatë zbatimit të kontratës.
3	Karpentier	2	Janë kërkuar karpentierë pasi në objekt parashikohen punime me kallëpe për betonim, kryesisht në puseta, depo, bazamente, mure, kolona, soleta, dhoma teknike dhe elementë të tjerë betonarme. Karpentierët garantojnë përgatitjen dhe montimin e kallëpeve sipas përmasave dhe kërkesave të projektit.
4	Hidroizolues	2	Janë kërkuar hidroizolues pasi objekti përfshin elementë që duhet të mbrohen nga depërtimi i ujit dhe lagështia, si depo grumbulluese, puseta, dhoma klorinimi, dhoma teknike dhe sipërfaqe betoni. Hidroizolimi është i nevojshëm për ruajtjen e funksionit të veprës, shmangien e infiltrimeve dhe rritjen e jetëgjatësisë së objektit.
5	Betonues	1	Është kërkuar betonues pasi në preventiv parashikohen punime betoni për puseta, depo, bazamente, mure, soleta, dhoma teknike dhe elementë të tjerë ndërtimorë. Ky punonjës është i nevojshëm për hedhjen, shpërndarjen, vibrimin dhe trajtimin korrekt të betonit, me qëllim garantimin e cilësisë së punimeve.
6	Hidraulik	3	Janë kërkuar hidraulikë pasi objekti kryesor është ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe përfshin vendosjen e tubacioneve, lidhjet e nyjeve, montimin e rakorderive, saracineskave, ajruesve, shkarkuesve, matësve dhe elementëve të tjerë hidraulikë. Ky staf është thelbësor për realizimin e saktë të rrjetit dhe testimin e tij.
7	Montator për konstruksione metalike	1	Është kërkuar montator për konstruksione metalike pasi objekti mund të përfshijë montimin e kapakëve metalikë, shkallëve metalike, mbajtëseve, elementëve në dhoma teknike, konstruksioneve ndihmëse dhe pjesëve mbajtëse për pajisje mekanike ose elektrike. Ky specialist garanton montimin e sigurt dhe funksional të këtyre elementëve.
8	Hekurkthyes	2	Janë kërkuar hekurkthyes pasi punimet përfshijnë elementë betonarme, si depo, puseta, bazamente, mure, kolona, soleta dhe dhoma teknike. Hekurkthyesit janë të nevojshëm për prerjen, përkuljen, vendosjen dhe lidhjen e armaturës sipas projektit konstruktiv.
9	Elektracist	2	Janë kërkuar elektrikistë pasi objekti mund të përfshijë instalime elektrike në stacione pompimi, dhoma teknike, panele elektrike, komandim,, tokëzim, mbrojtje elektrike, ndriçim teknik dhe pajisje elektromekanike. Këta punonjës janë të nevojshëm për montimin dhe lidhjen e instalimeve

Nr.	Stafi / profesioni i kërkuar	Sasia	Argumentimi i kriterit
10	Shoferë për drejtim mjetesh me kategori C/CE dhe/ose D/DE	2	elektrike në përputhje me projektin dhe kushtet teknike të sigurisë. Janë kërkuar shoferë pasi gjatë zbatimit të kontratës nevojitet transport materialesh, tubacionesh, inertesh, pajisjesh, makinerish të vogla dhe personeli drejt kantierit. Kërkesa për leje drejtimi të kategorive përkatëse lidhet me përdorimin e mjeteve të transportit gjatë realizimit të punimeve. Lejimi i kontraktimit me kontratë pune/shërbimi e bën kriterin proporcional.
11	Eskavatoristë	2	Janë kërkuar eskavatoristë pasi objekti përfshin hapje traseje, gërmime për vendosjen e tubacioneve, gërmime për puseta, depo, bazamente, dhoma teknike, nivelim terreni dhe rikthim të sipërfaqeve pas përfundimit të punimeve. Këta manovratorë janë të nevojshëm për përdorimin e sigurt të eskavatorëve dhe realizimin e punimeve të tokës.
12	Automakinist	1	Është kërkuar automakinist pasi gjatë zbatimit të punimeve mund të nevojitet përdorimi i mjeteve/makinerive të rënda për ngarkim, shkarkim, transport, vendosje materialesh dhe mbështetje të proceseve të punës në kantier. Ky punonjës garanton përdorimin e sigurt dhe korrekt të mjetit përkatës.
13	Buldozierist	1	Është kërkuar buldozierist pasi objekti përfshin punime sistemimi, pastrimi traseje, nivelimi, shtyrje materiali, mbushje, sheshim dhe rikthim të terrenit në gjendje funksionale pas përfundimit të punimeve. Ky specialist është i nevojshëm për përdorimin e buldozerit gjatë punimeve të tokës.
14	Kontrata pune/shërbimi dhe dokumentet e kualifikimit	Për stafin e kërkuar	Kërkesa për kontratë pune/shërbimi dhe dëshmi/diplomë profesionale vendoset për të provuar se operatori ekonomik e disponon realisht personelin e nevojshëm dhe se punonjësit kanë kualifikimin përkatës për profesionin që kryejnë. Kjo garanton që punimet të realizohen nga staf i kualifikuar dhe i aftë profesionalisht.
15	Kartelat personale të sigurimit teknik	Për specialistët përkatës	Kërkesa për kartelat personale të sigurimit teknik vendoset pasi punonjësit do të kryejnë punime në kantier, me makineri, pajisje ndërtimi, instalime elektrike, tubacione, betonime, armime dhe procese të tjera që paraqesin rrezik. Ky dokument vërteton se punonjësit janë të instruktuar për kryerjen e punës në kushte sigurie.

Kërkesa për stafin teknik të specializuar është vendosur në përputhje me natyrën, volumin dhe zërat e preventivit të objektit të prokurimit. Objekti përfshin punime ndërtimore, hidraulike, mekanike, elektrike, betonarme, hidroizoluese, transport materialesh dhe përdorim makinerish të rënda në kantier. Për këtë arsye kërkohet disponimi i punonjësve të kualifikuar për secilin proces

pune, me qëllim garantimin e zbatimit korrekt të projektit, cilësisë së punimeve, sigurisë në kantier dhe realizimit të kontratës brenda afateve.

Kërkesa është proporcionale me objektin e kontratës dhe nuk synon kufizimin e konkurrencës, pasi për shoferët dhe manovratorët lejohet disponimi edhe me kontratë pune/shërbimi deri në përfundimin e kontratës.

2.3.8 Makineri Pajisje

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme ne pronesi ose qira ose kontrate furnizimi:

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njesi	Sasia	Statusi
1	Eskavator me Goma	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
2	Eskavator me cekic me zinxhire	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
3	Fadrome me goma	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
4	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtës deri 20 ton	Copë	5	Ne pronesi ose me qera
5	Kamionçinë deri në 3.5 ton	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
6	Kamion me Vinc	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
7	Autobot Uji	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
8	Autobetoniere	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
9	Autopompe	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
10	Gjenerator	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
11	Aparat për ngjitje tubash me elektrofuzion	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
12	Aparat saldimi për ngjitje të tubave koke me koke	Cope	1	Ne pronesi ose me qera
13	Asfaltoshtruese	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
14	Matrapik	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
15	Rimorkiator	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
16	Vibrator	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
17	Betoniere	Copë	2	Ne pronesi ose me qera
18	Minieskavator	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
19	Greider	Copë	1	Ne pronesi ose me qera/ ose kontratë furnizimi

20	Rul	Copë	1	Ne pronesi ose me qera
21	Fabrikë betoni ose kontratë furnizimi Kur Fabrika e betonit është në pronësi, oe duhet të paraqesë edhe lejën mjedisore	Copë	1	Ne pronesi ose me qera

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”, si më poshtë vijon:

- Kokore + Jelekë fosforoshentë minimumi 50 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 10 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

- ❖ Kriteri konsiderohet i përmbushur me *plotësimin e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8*. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

Pajisjet dhe mjetet nuk duhet të jene të angazhuara në asnjë kontratë tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Si dëshmi për të vertetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike në pronesi/qira /kontrate furnizimi, do të paraqiten këto dokumenta:

- a) Për mjetet në pronesi (që shënohen në regjistra publikë), duhet të paraqiten;- dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), -plus certifikatën e kontrollit teknik, -siguracionin e mjetit (te vlefshme), vertetimin e pagesës për taksat vjetore.
- b) Për mjetet e siguruar me qira, duhet të paraqiten; -dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme), vertetimin e pagesës për taksat vjetore, kontrata e qirase e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.

Për pajisjet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi), të vlefshme.

Për pajisjet me qira të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt shoqëruar me akt pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi), të vlefshme.

Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara, do te jene te angazhuara vetem ne kete kontrate. Mjetet te cilat rezultojne te angazhuara ne kontrata te tjera afati i zbatimit te cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojte dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

** Kriteri konsiderohet i permbushur me vetedeklarimin sipas Formularit Permbledhës të Vetedeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetedeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. _Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin përcaktohet: *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Në nenin 39 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike” pika 6 /d të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 te ndryshuar parashikohet: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj kerkohet që operatorët ekonomike t’i disponojnë ato pasi nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve /makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, kjo njesi eshte bazuar tek zerat dhe volumet e preventivit dhe specifikimet teknike te hartuara nga Projektuesi. Mjetet e kërkuara përkojnë me proceset ndërtimore sipas zërave të preventivit dhe jane percaktuar ne varesi te volumeve te punimeve dhe kohes se realizimit te vepres.

Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon çertifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar, Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshme paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit ne lidhje me mjetet e pajisjet teknike që operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Nr. Mjeti / pajisja	Sasia	Argumentimi i kërkesës
1 Eskavator me goma	2 copë	Janë kërkuar eskavatorë me goma pasi objekti përfshin punime lineare për hapje traseje, gjurmime për vendosjen e tubacioneve, hapje gropash për puseta, depo, nyje lidhëse dhe elementë të tjerë të rrjetit të ujësjellësit. Eskavatori me goma është i përshtatshëm për lëvizje në rrugë dhe segmente urbane/rurale pa dëmtuar sipërfaqet ekzistuese. Kërkesa për 2 copë lidhet me nevojën për hapjen e disa fronteve pune dhe për përfundimin e punimeve brenda afatit kontraktor.
2 Eskavator me çekiç me zinxhirë	1 copë	Është kërkuar eskavator me çekiç me zinxhirë pasi gjatë hapjes së trasesë mund të hasen formacione të forta shkëmbore, beton, asfalt ose shtresa të ngjeshura që nuk mund të gjurmohen me pajisje të zakonshme. Ky mjet është i nevojshëm për thyerjen e materialeve të forta dhe hapjen e trasesë në kushte të vështira terreni.
3 Fadromë me goma	1 copë	Është kërkuar fadromë me goma pasi gjatë zbatimit të punimeve nevojitet ngarkim-shkarkim i materialeve, inerteve, dherave të gjurmimit, çakëllit, rrës dhe materialeve të tjera të kantierit. Ky mjet shërben edhe për sistemim, pastrim, nivelim të përkohshëm dhe mbështetje të proceseve të mbushjes dhe rikthimit të terrenit.
4 Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës deri 20 ton	5 copë	Janë kërkuar kamionë vetëshkarkues pasi objekti përfshin transport të dherave të dala nga gjurmimi, transport inertesh, çakëlli, rrëse, materialesh ndërtimi dhe mbetjeve të kantierit. Numri 5 copë lidhet me volumin e punimeve, karakterin linear të objektit dhe nevojën për furnizim të largim materialeve pa ndërprerë frontet e punës.
5 Kamionçinë deri në 3.5 ton	1 copë	Është kërkuar kamionçinë deri në 3.5 ton për transportin e mjeteve të vogla të punës, veglave, pajisjeve, materialeve ndihmëse, rakorderive, tubave me diametër të vogël, pjesëve rezervë dhe personelit teknik në kantier. Ky mjet është i nevojshëm për lëvizje të shpejta dhe furnizime të përditshme gjatë zbatimit.
6 Kamion me vinç	1 copë	Është kërkuar kamion me vinç pasi gjatë punimeve nevojitet ngritja, ngarkimi, shkarkimi dhe vendosja e materialeve të rënda, si tubacione, puseta të parafabrikuara, armatura, pajisje mekanike, saracineska, elementë metalikë dhe materiale të tjera voluminoze. Ky mjet garanton manovrim të sigurt dhe ul rrezikun gjatë ngarkim-shkarkimit.
7 Autobot uji	1 copë	Është kërkuar autobot uji pasi gjatë punimeve nevojitet ujë për uljen e pluhurit në kantier, lagjen e shtresave gjatë ngjeshjes, pastrimin e zonës së punës, kujdesin ndaj betonit dhe mbështetje gjatë provave apo proceseve teknike që kërkojnë furnizim me ujë në terren.

Nr. Mjeti / pajisja	Sasia	Argumentimi i kërkesës
8 Autobetoniere	1 copë	Është kërkuar autobetoniere pasi në objekt parashikohen punime betoni për puseta, depo, dhoma teknike, bazamente, mure, soleta dhe elementë të tjerë ndërtimorë. Autobetoniereja siguron transportin e betonit në kantier në kushte të përshtatshme teknike dhe ruajtjen e cilësisë së tij deri në hedhje.
9 Autopompë betoni	1 copë	Është kërkuar autopompë betoni pasi disa elementë të objektit, si depo, mure, soleta, puseta ose dhoma teknike, mund të kenë pozicion të vështirë për hedhjen direkte të betonit. Autopompa mundëson hedhjen e betonit në mënyrë të kontrolluar, të shpejtë dhe cilësore, sidomos në zona ku nuk ka akses të drejtpërdrejtë për autobetoniere.
10 Gjenerator	1 copë	Është kërkuar gjenerator pasi punimet zhvillohen në terren dhe mund të ketë mungesë furnizimi me energji elektrike. Gjeneratori është i nevojshëm për funksionimin e pajisjeve elektrike të kantierit, ndriçimit, pompave të përkohshme, aparateve të saldimit/ngjitjes së tubave dhe veglave të tjera të punës.
11 Aparat për ngjitje tubash me elektrofuzion	1 copë	Është kërkuar aparat elektrofuzioni pasi në rrjetet e ujësjellësit me tuba HDPE përdoren lidhje me rakorderi elektrofuzioni për nyje teknike, degëzime, bashkime, lidhje me saracineska dhe elementë të tjerë të rrjetit. Ky aparat garanton lidhje të sigurt, hermetike dhe të përshtatshme për rrjete nën presion.
12 Aparat saldimi për ngjitje tubash kokë më kokë	1 copë	Është kërkuar aparat saldimi kokë më kokë pasi tubacionet HDPE të ujësjellësit kërkojnë bashkime të sigurt dhe të qëndrueshme përgjatë trasesë. Kjo pajisje është e domosdoshme për saldimin korrekt të tubave sipas diametrit, presionit dhe specifikimeve teknike të projektit.
13 Asfaltoshtruese	1 copë	Është kërkuar asfaltoshtruese pasi objekti përfshin ndërhyrje në rrugë të asfaltuara dhe zëra për rikthimin e shtresave asfaltike në gjendjen e mëparshme pas vendosjes së tubacionit. Kjo pajisje garanton shtrimin e asfaltit me cilësi, trashësi dhe uniformitet sipas kërkesave teknike.
14 Matrapik	1 copë	Është kërkuar matrapik pasi gjatë zbatimit mund të ketë nevojë për thyerje lokale të betonit, asfaltit, muraturës ose materialeve të forta në segmente ku makineritë e mëdha nuk mund të punojnë. Matrapiku është pajisje ndihmëse e nevojshme për ndërhyrje të kufizuara dhe punime korrigjuese në kantier.
15 Rimorkiator	1 copë	Është kërkuar rimorkiator pasi objekti kërkon transportimin e makinerive të rënda, si eskavatorë, buldozer, rul, greider ose pajisje të tjera nga një front pune në tjetrin. Ky mjet është i nevojshëm për mobilizimin e shpejtë të makinerive dhe organizimin normal të kantierit.
16 Vibrator betoni	2 copë	Janë kërkuar vibratorë betoni pasi në objekt parashikohen punime betonarme për puseta, depo, bazamente, mure, soleta dhe dhoma

Nr. Mjeti / pajisja	Sasia	Argumentimi i kërkesës
17	Betoniere	2 copë
18	Minieskavator	1 copë
19	Greider	1 copë
20	Rul	1 copë
21	Fabrikë betoni ose kontratë furnizimi	1 copë / kontratë
22	Kokore dhe jelekë fosforeshentë	Minimumi 50 copë
23	Fikëse zjarri të lëvizshme	Minimumi 10 copë
24	Prozhektorë ndriçimi natën	Minimumi 4 copë

teknike. Vibratori është i domosdoshëm për ngjeshjen e betonit, eliminimin e boshllëqeve dhe garantimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së elementëve prej betoni.

Janë kërkuar betoniere për përgatitjen në kantier të sasive të vogla të betonit ose llaçit, të nevojshme për punime ndihmëse, riparime, vendosje pusetash, muratura, bazamente të vogla dhe ndërhyrje lokale. Kërkesa është e lidhur me nevojën për punime të shpejta dhe të shpërndara përgjatë trasesë.

Është kërkuar minieskavator pasi në segmente të ngushta, pranë banesave, rrugëve të brendshme, infrastrukturave ekzistuese ose ambienteve me hapësirë të kufizuar nuk mund të përdoren makineri të mëdha. Minieskavatori është i nevojshëm për gjurmime të kontrolluara dhe me ndikim minimal në terren.

Është kërkuar greider në rast për punime sistemimi, nivelimi, profilimi rruge, përgatitje të shtresave, rikthim të rrugëve të prekura nga punimet ose sistemim të shesheve të kantierit. Greideri garanton nivelim të saktë dhe përgatitje të sipërfaqes sipas kërkesave teknike.

Është kërkuar rul pasi pas vendosjes së tubacioneve nevojitet ngjeshja e shtresave të mbushjes, çakëllit, rrugëve të prekura dhe sipërfaqeve të rikthyera. Ruli siguron kompaktimin e duhur të materialit, shmang uljet e mëvonshme të terrenit dhe garanton qëndrueshmërinë e shtresave.

Është kërkuar fabrikë betoni ose kontratë furnizimi pasi objekti përfshin punime betoni në depo, puseta, bazamente, mure, soleta, dhoma teknike dhe elementë të tjerë ndërtimorë. Kërkesa garanton furnizim të vazhdueshëm me beton të përshtatshëm, me cilësi dhe klasë sipas projektit. Lejimi i kontratës së furnizimit e bën kriterin proporcional, pasi operatori ekonomik nuk detyrohet të ketë fabrikë në pronësi. Nëse fabrika është në pronësi, kërkesa për leje mjedisore është e lidhur me veprimtarinë prodhuese të betonit.

Janë kërkuar për mbrojtjen individuale të punonjësve dhe identifikimin e tyre në kantier. Duke qenë se objekti përfshin punime me makineri, gjurmime, transport materiale dhe qarkullim mjetes, këto pajisje janë të nevojshme për uljen e rrezikut të dëmtimeve dhe për rritjen e sigurisë në kantier.

Janë kërkuar për parandalimin dhe ndërhyrjen fillestare në rast zjarri në kantier, veçanërisht pranë paneleve elektrike, gjeneratorëve, makinerive, ambienteve teknike, magazinimit të materialeve dhe pajisjeve elektromekanike.

Janë kërkuar për sigurimin e ndriçimit të kantierit në rast punimesh në orët me ndriçim të pamjaftueshëm, për ruajtjen e

Nr. Mjeti / pajisja	Sasia	Argumentimi i kërkesës
25	Komplet i ndihmës së shpejtë	Minimumi 5 copë
26	Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt	Minimumi 10 copë
		sigurisë së punonjësve dhe për shmangien e aksidenteve gjatë punimeve, qarkullimit të mjeteve apo ruajtjes së kantierit. Janë kërkuar për dhënien e ndihmës së parë në rast aksidenti, dëmtimi ose emergjence shëndetësore gjatë punimeve. Duke qenë se punimet zhvillohen në terren dhe në disa fronte pune, është e nevojshme që kompleti i ndihmës së shpejtë të jetë i disponueshëm në kantier. Janë kërkuar për sinjalizimin e zonave të rrezikshme, gjurmimeve, lëvizjes së makinerive, punimeve në rrugë, hyrje-daljeve të kantierit dhe kufizimit të aksesit të personave të paautorizuar. Kjo masë është e nevojshme për sigurinë e punonjësve, banorëve dhe përdoruesve të rrugës.

Kërkesa për disponimin e makinerive, pajisjeve teknike dhe mjeteve të mbrojtjes në punë është vendosur në përputhje me natyrën, volumn dhe zërat e preventivit të objektit të prokurimit. Objekti lidhet me ndërtimin e një sistemi ujësjellësi dhe përfshin punime gjurmimi, hapje traseje, vendosje tubacionesh HDPE, ndërtim pusetash, depo, dhoma teknike, punime betoni, transport materiale, rikthim të sipërfaqeve të prekura, sistemim terreni, ngjeshje dhe masa sigurie në kantier.

Makineritë dhe pajisjet e kërkuara janë të nevojshme për realizimin e proceseve kryesore të punës, sigurimin e vijueshmërisë së punimeve, uljen e vonësve, përmbushjen e afatit të kontratës dhe garantimin e cilësisë së zbatimit. Kërkesa për disponim në pronësi ose me qira e bën kriterin proporcional dhe jo kufizues, pasi operatori ekonomik nuk detyrohet t'i ketë të gjitha mjetet në pronësi.

Kërkesa që mjetet të mos jenë të angazhuara në kontrata të tjera gjatë periudhës së zbatimit të kësaj kontrate vendoset për të garantuar disponueshmërinë reale të tyre në kantier dhe për të shmangur riskun e vonësve në zbatimin e punimeve. Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë disponueshmërinë e mjeteve gjatë vlerësimit të ofertave dhe gjatë zbatimit të kontratës.

Pajisjet e mbrojtjes në punë dhe sinjalistika e kantierit kërkohen në zbatim të rregullave për sigurinë në kantier dhe janë të domosdoshme për mbrojtjen e punonjësve, kalimtarëve, banorëve dhe përdoruesve të rrugës gjatë kryerjes së punimeve. Mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes në punë të punëtorëve dhe personelit janë kërkuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”

Kriteri konsiderohet proporcional me objektin e kontratës, pasi lidhet drejtpërdrejt me zërat e punimeve dhe me nevojën për zbatimin teknik, cilësor dhe të sigurt të objektit.

2.3.9 Afati i kryerjes së punimeve

Afati i kryerjes së punimeve është sipas Grafikut të Punimeve të publikuar ne SPE

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë deklaratën **ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të perfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, në rast të shpalljes fitues.**

Argumentim për pikën 2.3.9 – Afati i kryerjes së punimeve

Është kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, pasi objekti i prokurimit përfshin punime ndërtimi për realizimin e ujësjellësit, të cilat duhet të organizohen sipas fazave të zbatimit, zërave të preventivit dhe afatit kontraktor.

Grafiku i punimeve është i nevojshëm për të provuar se operatori ekonomik ka planifikuar në mënyrë reale organizimin e kantierit, mobilizimin e stafit, makinerive dhe materialeve, si dhe realizimin e punimeve sipas rendit logjik të zbatimit. Ky grafik ndihmon në shmangien e vonesave, mbivendosjes së proceseve të papajtueshme dhe ndërprerjes së ecurisë normale të punimeve.

Duke qenë se objekti përfshin punime të ndryshme si gjurmime, hapje traseje, vendosje tubacionesh, ndërtim pushtash, depo, dhoma teknike, punime betoni, montime hidraulike, mekanike dhe elektrike, është e domosdoshme që operatori ekonomik të paraqesë një plan kohor të qartë për realizimin e tyre brenda afatit të përcaktuar.

Kërkesa për deklaratën e pranimit të afatit dhe mënyrës së financimit vendoset për të siguruar që operatori ekonomik është njohur me kushtet e kontratës, grafikun e punimeve të publikuar në SPE dhe mënyrën e financimit të objektit, si dhe pranon të realizojë punimet brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, në rast shpalljeje fitues.

Kjo kërkesë nuk synon kufizimin e konkurrencës, por garantimin e seriozitetit të ofertës, planifikimit të saktë të zbatimit dhe përfundimit të punimeve brenda afatit kontraktor.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vertetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si me siper ose të kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për keto sqarime në përputhje me nenin 24 pika 1 të VKM nr.28 datë 19.05.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

Në funksion të plotësimit të Shtojcës Nr. 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Atësi, Amësi, Datëlindje, Vendlindje, Numër Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin / Administratorët e shoqërise, Ortakun / Ortakët e shoqërise, përfaqësues të ndryshëm të posacëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Bazuar në parashikimet e Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin;

Si dhe sipas Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 neni 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Pika 5 ku parashikohet: “Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

- a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;
- b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e parashikuar në pikën 6 të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1 të LPP-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim për dorëzimin e dokumentacionit provues

Dokumentacioni provues duhet të dorëzohet i plotë, i vlefshëm dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Dokumentet duhet të jenë të vlefshme në datën e hapjes së ofertave dhe, kur natyra e dokumentit e kërkon, të mbulojnë të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës.

Në rast se dokumentet përmbajnë paqartësi formale, Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë sqarime ose dokumentacion mbështetës, pa cenuar parimin e trajtimit të barabartë dhe pa lejuar ndryshimin e përmbajtjes thelbësore të ofertës.

Nëse operatori ekonomik nuk dorëzon dokumentacionin provues brenda afatit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, ose nëse nga verifikimi rezulton se të dhënat e vetëdeklaruar nuk përputhen me dokumentet provuese, oferta konsiderohet se nuk përmbush kriteret e kualifikimit.

Shënim për mënyrën e ngarkimit të dokumentacionit në sistem

Operatori ekonomik duhet të ngarkojë në sistem dokumentacionin provues në mënyrë të rregullt, të qartë dhe të organizuar, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikat e D.S.T.

Dokumentet duhet të paraqiten sipas secilit kriter të kërkuar në DST, duke bërë të mundur identifikimin e lehtë të tyre nga Autoriteti Kontraktor gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit.

Operatori ekonomik duhet të shmangë ngarkimin e dokumenteve të panevojshme, të përsëritura, të paorganizuara ose që nuk kanë lidhje me kriteret e kërkuara në DST, pasi një praktikë e tillë vështirëson procesin e shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit.

Dokumentacioni i ngarkuar duhet të jetë i plotë, i lexueshëm, i vlefshëm dhe të korrespondojë drejtpërdrejt me kërkesat përkatëse të DST-së. Çdo dokument duhet të lidhet qartë me kriterin që synon të provojë, në mënyrë që të shmangen paqartësitë gjatë vlerësimit.

Në rast se dokumentacioni i ngarkuar është i paqartë, i shpërndarë, i palexueshëm, i paplotë ose nuk provon përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në DST, Autoriteti Kontraktor do të veprojë në përputhje me parashikimet e legjislacionit të prokurimit publik dhe dokumenteve të tenderit.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar nga shoqëria projektuese në kuadër të projekt-zbatimit dhe janë përcjellë si pjesë e dokumentacionit teknik për realizimin e punimeve.

Njësia e prokurimit, pas shqyrtimit të tyre, vlerëson se specifikimet teknike janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës, projektin teknik, preventivin dhe zërat e punimeve që do të realizohen.

Specifikimet teknike përcaktojnë kërkesat minimale për cilësinë e materialeve, mënyrën e zbatimit të punimeve dhe standardet teknike që duhet të respektohen gjatë realizimit të objektit.

Ato janë hartuar në përputhje me nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenin 40 pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, te ndryshuar, duke mos kufizuar konkurrencën dhe duke lejuar zgjidhje ose dokumente ekuivalente, kur është e aplikueshme.